




**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL VIII/2026

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VIII (tetë) për vitin 2026 të Komitetit për
Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 25.08.2026
Ora : 09:00

Prezentë:

Znj. Shkendije Shabanaj-Kryesuese

z.Nazim Shabanaj

znj.Merita Basha

z.Zek Berisha

znj.Amira Sofra

z.Aziz Bytyqi

z.Urim Suka

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj- Zyrtar për Kthim dhe Komunitete

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore

Zyra për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e cila propozoi këtë:

Rend Dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Komunën e Suharekës;

3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtora të Shkollave;

4. Të ndryshme;

Kryesuesja- i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim

Unanimisht miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja- sugjeron që në procesverbal të përfshin pyetjet dhe rekomandimet të cilat i bën ajo.

Unanimisht miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Komunën e Suharekës;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka- përshendetje për të gjithë, desha një sqarim me ditë a ka njerëz që kanë ardhë apo qysh janë statistikuar për këtë pjesë sa na hyn në punë ky plan, a ka njerëz që duhet me u riatdhesu me u integru në shoqëri, për deri sa se kemi zyrtarin këtu unë vetëm pe adresoj si pyetje ndoshta në Asamble marrim përgjigje.

Kryesuesja- edhe unë jam e përfshirë në këtë plan, mirë është me pas planin sepse një kohë ka pas fluks të madhë, shumë, shumë familje kemi pas probleme me u riatdhesu sidomos femijet me u rikthyer në Shkollë, njoftim dokumentave kështu që është mirë me pas si Komunë për qdo rast 2-3 familje sa janë me ditë me u trajtu.

Nazim Shabanaj- në këtë vit a ka pas ndonjë rast?

Kryesuesja- jo

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtora të Shkollave;

Kryesuesja- e elaboron pikën dhe hap debatin

Urim Suka- mua po më shqetëson vonesat që ndodhin te emerimi i Drejtorave sepse ne kemi disa Shkollë që udhëhiqen me ushtrues detyre që një kohë të gjatë dhe është desht me ndodh shumë më herët me ndodhë kjo procedurë.

Kryesuesja- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4. Të ndryshme;

Kryesuesja- desha me ju informu rreth kërkeses që e kam bërë lidhur me anëtorët e urës në fshatin Gelancë, kërkesa është aprovu dhe tash veq se ekzistojnë anëtorët e reja dhe e falenderojmë Komunën e cila na ka mbështetur.

Nazim Shabanaj- kërkon riparimin e këndit të lojtrave në fshatin Gelancë.

Kryesuesja- do e bëjmë një kërkesë me shkrim.

Takimi përfundoi: 9:20